



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 280/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Kushtrim Krasniqi mbështetës i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të kërcënimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV, me të cilën pretendohet se më datën 08.06.2014 rreth orës 16:44, Rina Thaçi vëzhguese e LVV-së në vendvotimin 2042a/11r është kërcënuar nga një person me emrin Kushtrim Krasniqi, pas një raportimi për shitje të votës që e ka bërë. Sipas parashtruesit të ankesës, Kushtrim Krasniqi është nipi i Nait Hasanit kandidat për deputet në PDK, me çka sipas parashtruesit të ankesës, personi në fjalë është mbështetës i subjektit politik PDK dhe se subjekti politik në fjalë është përgjegjës sipas nenit 5.1 të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr. 11/2013. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën e Rina Thaçit vëzhguese e LVV-së.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi informata më të hollësishme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se vëzhguesja Rina Thaçi është intervistuar nga zyrtarët policor dhe pas intervistimit nga hetimet preliminare, nuk është vërejtur se ka elemente kërcënimi dhe se vet ajo ka deklaruar se nuk e ndien veten të kanosur nga ky person.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohen pretendimet ankimore. Për më tepër, nga raporti i policisë së Kosovës rezulton se gjatë ndërmarrjes së veprimeve hetimore nga ana e Policisë së Kosovës nuk kanë arritur që të gjejnë se ndaj vëzhgueses së LVV-së ka pasur ndonjë kërcënim, prandaj PZAP-i vendosi se një pretendim i tillë i ankesës se në vendvotimin 2042a/11r personi me emrin Kushtrim Krasniqi ka kërcënuar vëzhguesen e LVV-së Rina Thaçi, është i pa argumentuar dhe i pa bazuar në fakte dhe prova, dhe si e tillë ankesa është e pa bazë, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 280/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*